



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

**BURSA STUDIMI NË UNIVERSITETIN TEKNIK TË STAMBOLLIT (UTS) TURQI,
VITI AKADEMIK 2021-2022**

Në kuadër të bashkëpunimit dypalësh të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) të Republikës së Shqipërisë me Universitetin Teknik të Stambollit (UTS) në Republikën e Turqisë, si edhe Memorandumit të Mirëkuptimit të nënshkruar mes palëve të sipërcituara, MASR shpall thirrjen për përfitimin e të drejtës së studimit (ku përfshihet tarifa e shkollimit dhe pagesa e konviktit) për shtetasit shqiptarë, të cilët dëshirojnë të ndjekin studimet pranë Universitetit Teknik të Stambollit, në ciklin e studimit Bachelor, për vitin akademik 2021-2022, në fushat e studimit që ofron UTS. Kandidatët preferohen nga shkollat e mesme publike.

Të interesuarit duhet të dërgojnë me postë pranë MASR, brenda datës **10 gusht 2021** (vula postare), dokumentacionin si më poshtë:

1. Kërkesën e nënshkruar për aplikim në programet e studimit sipas shtojcës bashkëlidhur;
2. Kopje të noterizuara të Diplomës së Maturës Shtetërore dhe listës së notave (kandidatët duhet të kenë notë mesatare të arsimit të mesëm dhe të provimeve të MSH mbi 9);
3. Kopjen e noterizuar të certifikatës ndërkombëtare të njohjes së gjuhës angleze TOEFL PBT + TWE; TOEFL IBT; PTE;
4. Letrën e motivimit të kandidatit, duke përcaktuar qartë programet e studimit ku kërkon të aplikojë (të renditura sipas preferencës);
5. Kopjen e noterizuar të pasaportës ose të ID.

Kandidatët mund të aplikojnë deri në tre (3) programe të ndryshme dhe vendosja do të bëhet në përputhje me përparësinë e përzgjedhjes së tyre. Pas përfundimit të fazës së parë të përzgjedhjes, që është aplikimi me dokumentacion, kandidatët do të njoftohen nëpërmjet postës elektronike, nëse janë përzgjedhur ose jo për të kaluar në fazën e dytë të përzgjedhjes që është intervista. Në çdo rast, vendimi përfundimtar për pranimin për studime në UTS i takon Universitetit Teknik të Stambollit. Informacione më të detajuara në lidhje me programet e studimit që ofrohen nga Universiteti Teknik i Stambollit në Turqi mund t'i gjeni në faqen e internetit:

<https://www.itu.edu.tr/en/all-departments>